URDHËR
Nr. 876, datë 25.6.2021

PËR DELEGIM KOMPETENCASH PËR NËNSHKRIMIN E PRAKTIKAVE PËR DHËNIE NDIHME FINANCIARE PËR USHTARAKËT E FORCAVE TË ARMATOSURA

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të ndryshuar; të germës "f", të pikës 2, të nenit 13, të ligjit nr. 64/2014, datë 26.6.2014, "Për pushtetet dhe autoritetet e drejtimit e të komandimit të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar; të neneve 28, 29 dhe 113, të ligjit nr. 44/2015, "Kodi i Procedurës Administrative të Republikës së Shqipërisë"; të nenit 30, të ligjit nr. 9210, datë 23.3.2004, "Për statusin e ushtarakut të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Delegimin e kompetencës për nënshkrimin e praktikave për dhënien e ndihmave financiare të menjëhershme për ushtarakët e Forcave të Armatosura, me propozim të Shefit të Shtabit të Përgjithshëm të FA-së, te zëvendësministri i Mbrojtjes, znj. Dallëndyshe Bici.
2. Ngarkohet zëvendësministri i Mbrojtjes dhe Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura për zbatimin e këtij urdhri.
3. Urdhri nr. 462, datë 16.3.2015, i Ministrit të Mbrojtjes, "Për delegim kompetencash për dhënien e ndihmës financiare për ushtarakët e Forcave të Armatosura", shfuqizohet.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I MBROJTJES
Niko Peleshi